

Ky material mbeshtetet ne VKM nr 759 date 15.09.2010 "Per kuotat financiare te ushqimit ne mensa e konvikte,bursat e shtetit dhe pagesat e nxenesve e te studenteve,ne institucionet arsimore publike,per vitin shkollor 2010-2011"

Studentet qe ndjekin nje program studimi te ciklit te pare,me kohe te plote,ne institucionet arsimore publike mund te perfitojne burse nga Buxheti vjetor i miratuar nga MASH.

Studentet mund te perfitojne burse,brenda kriterëve te percaktuara ne kete vendim:

A-Sipas kriterit ekonomik:

a)Studenti qe vazhdon studimet larg vendbanimit te tij ne largesine mbi 5 km dhe ploteson kriterin e konomik sipas ketij vendimi.

b)Studentet qe kane perfitur statusin e jetimit dhe plotesojne kriterin ekonomik.

c)Studentet qe kane humbur kujdestarine prinderore me vendim gjykate te formes se prere dhe qe plotesojne kriterin ekonomik.

d)Secili nga studentet,bashkeshort me femije qe ploteson kriterin ekonomik dhe vendoset ne konvikt publik.

f)Studenti qe ka statusin e invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik,dhe ploteson kriterin ekonomik.

KRITERET EKONOMIKE TE STUDENTIT PER DHENIEN E BURSES 2010-2011

Per Qytetin
leke)

Te ardhurat mujore per fryme (ne

Nr	Perberja familjare	Bursa	Gjysme bursa	Me pagese
1	Familjet me 2 persona	Deri 3200	3200-4600	Mbi 4600
2	Familjet me 3 persona	Deri 3100	3100-4500	Mbi 4500
3	Familjet me 4 persona	Deri 3000	3000-4400	Mbi 4400
4	Familjet me 5 persona	Deri 2900	2900-4300	Mbi 4300
5	Familjet me 6 persona	Deri 2800	2800-4200	Mbi 4200
6	Familjet me 7 persona	Deri 2700	2700-4100	Mbi 4100
7	Familjet me 8 persona	Deri 2600	2600-4000	Mbi 4000

.

Për fshatin:

Studentët nga fshati përfitojnë bursë, kur familja e tyre përfiton ndihmë ekonomike, në varësi të masës së kësaj ndihme.

B-Sipas rezultateve të arritura.

a) Studentet që regjistrohen në vitin e parë të shkollës së Lartë, që kanë mbaruar shkollën e mesme me Medalje Ari.

b) Studentet që regjistrohen në vitin e parë të shkollës së lartë dhe që janë shpallur si më të mirët e Matures shtetërore, sipas listave të vlerësimit. Këta studentë këtu bursë e fitojnë kur vazhdojnë studimet në institucionet e arsimit të lartë publik dhe vetëm për vitin shkollor 2010-2011.

c) Studentet që kanë mbaruar vitin akademik pararendës me të gjitha notat 10 (dhjetë).

d) Studentet që vazhdojnë studimet në specialitetin matematikë dhe në fizikë, në vitet e dyta të lartë dhe kanë mbaruar vitin pararendës me notën mesatare mbi 8 (tete).

C) Jashtë kriterit ekonomik.

a) Femijet studentë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardes së Republikës, të Sherbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Sherbimit Informativ Shtetëror dhe Policisë së Burgjeve që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës sipas listës që dërgon në MASH Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme dhe SHISH.

Studentet e të gjitha kategorive nuk përfitojnë bursë ose humbasin të drejtën e përfitimit të bursës, kur:

a) janë ndarë nga trangu familjar

b) familjet e tyre ushtrojnë veprimtari private

c) vazhdojnë një program të dytë studimi

d) Shpallen ngeles dhe humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokaluese.

Bursat e studentëve të viteve të dyta të lartë, rishqyrtohen dhe miratohen, çdo vit nga institucionet e arsimit të lartë. Studentët e viteve të dyta të lartë që nuk kanë përfituar bursë me parë dhe plotësojnë kriterin ekonomik, mund të përfitojnë bursë brenda numrit të bursave të dërguar nga MASH për institucionin.

Studentet qe kane perfituar statusin e jetimit perfitojne falas veshmbathje, libra ,fletore ne kuoten 10000 leke ne nje vit akademik. Gjithashtu ketyre studenteve u sigurohet falas,nga institucioni arsimor sherbimi shendetesor ,sherbimi dentar dhe medikamentet,pas paraqitjes se librezes dhe kartes shendetesore dhe epikrizes nga qendra spitalore e rrethit.

Keta studente e perfitojne bursen edhe gjate pushimeve verore dhe vetem nje vit kur humbasin vitin shkollor per arsye te rezultateve. Jokaluese

Bursat paguhen cdo muaj duke kaluar ne llogarine bankare te cdo studenti bursist.

Afati perfundimtar i shqyrtimit dhe miratimit te bursave per vitet e para ne te gjitha kategorite e shkollave eshte data 15 dhjetor 2010 dhe per vitet e dyta e larte data 15 nentor 2010.

Ne rastet e vecanta,kur vendimet e keshillave te njesive te pushtetit vendor dergohen jashte afatit te percaktuar ne kete vendim,eshte Ministri i Arsimit dhe Shkences qe ka te drejte te shqyrtoje dhe rivendose ne afat perfitimin e burses per studentin.

Cilat janë dokumentat e aplikimit për bursë?

Për studentët nga qyteti:

- 1.Vërtetim te statusit te studentit.
- 2.Certifikatë familjare.
- 3.Vërtetim page për cdo të punësuar në familje.
- 4.Vërtetim papunësie për të papunët nga Zyra e Punes ne bashkine perkatese.
- 5.Vërtetim për pjesetaret e familjes që vazhdojnë shkollën.
- 6.Vërtetim nga Sig.Shoqerore nëse përfitohen pensione të ndryshme.
- 7.Vërtetim nga Zyra e Tatim –Taksave për veprimtari private te familjes.
- 8.Vërtetim nga Zyra e Kadastres për tokë në pronësi të familjes.

Për studentët nga fshati.

- 1.Vërtetim te statusit te studentit.
- 2.Certifikatë familjare.
- 3.Vërtetim për masën e ndihmës ekonomike që përfiton familja.
- 4.Vertetim nese ka toke ose jo ne pronesi dhe perdorim.

